



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUČITRIN

Nr. / Br. 32814 / 24A

Nr. i fq. / Br. sh. _____

Data: / Datum: 09.07.2024

VUSHTRRI - VUČITRIN



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn-Municipality of Vushtri

**Procesverbali nga dëgjimi buxhetor me banorët e fshatrave Samadrexhë,
Ceceli, Sllakoc, Zagorë dhe Kunovik**

PROCESVERBAL

Nga dëgjimi publik me qytetarë për përgatitjen e buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2025, mbajtur me banorët e Këshillit Lokal Samadrexhë, që përfshin fshatrat Samadrexhë, Ceceli, Sllakoc, Zagorë dhe Kunovik.

Vendi: Shkolla "Lumni Surdulli" Samadrexhë

Ora: 19:30

Data: 05.07.2024

Të pranishëm nga komuna ishin: Melihate Basholli Latifi, kryesuese e Kuvendit të Komunës, Bekim Zabërgja, asamblist, Albiona Isa, Mirjeta Duraku dhe Donjetë Latifi.

Melihate Basholli Latifi, kryesuese, hapi mbledhjen me qytetarë, ku edhe paraqiti buxhetin e Komunës së Vushtrrisë për vitin 2025 dhe projektet e parapara për fshatrat e Këshillit Lokal Samadrexhë.

Gjithashtu, qytetarëve të pranishëm në këtë dëgjim ju është shpërnda material informues për buxhetin e vitit 2024.

Më pas fjala ka kaluar tek qytetarët pjesëmarrës në këtë takim për të paraqitur kërkesat e tyre.

Ditar Basholli, banor i fshatit Samadrexhë, tha se ka ankesë pasi që Klubi i Hendbollit për meshkuj "Samadrexha", kanë mbetur pa subvencionim pasi që gjatë aplikimit ju kanë munguar raporti financiar dhe narrativ.

Mehdi Maloku, banor i fshatit Samadrexhë, tha se rrugët kanë nevojë për asfaltim, ujësjellës dhe kanalizim.

Adem Maloku, banor i fshatit Samadrexhë, tha se rruga "Sokol Hyseni", ka nevojë për asfaltim.

Zejnullah Maloku, banor i fshatit Samadrexhë, tha se rruga "Selman Maloku", duhet të asfaltohet.

Alban Maloku, banor i fshatit Samadrexhë, tha se rruga te varrezat ka nevojë të lirohet pasi që është e bllokuar ose të bëhet një parking.

Sami Surdulli, banor i fshatit Samadrexhë, tha se rruga "Ismajl Haziri" (950m), rrugë e cila lidh fshatin Dumnicë me Samadrexhën, ka nevojë të vazhdohet asfaltimi.

Kujtim Maloku, banor i fshatit Samadrexhë, tha se rruga e lagjes "Maloku", e cila gjendet pranë shkollës së fshatit, vitin e kaluar është dëmtuar nga reshjet. Kjo rrugë është e gjatë 400m dhe lidh 14 shtëpi. Gjithashtu kjo rrugë ka problem mbeturinat dhe pranë saj gjendet një përrockë, për të cilën duhet të intervenohet urgjentisht.

Lulzim Surdulli, banor i fshatit Samadrexhë, dha ide për ndërtimin e një stacioni të autobusëve dhe një qendër të zjarrfikësve.

Takimi me qytetarë për përgatitjen e buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2025, mbajtur me banorët e Këshillit Lokal Samadrexhë, që përfshin fshatrat Samadrexhë, Ceceli, Sllakoc, Zagorë dhe Kunovik, përfundoi në ora 20:30.

Në këtë takim morën pjesë 9 qytetarë.

Procesmbajtëse:

Albiona Isa





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn-Municipality of Vushtrri



Lista e pjesëmarrësve

Dëgjimet buxhetore për buxhetin e vitit 2025

Vendi: Samadrexhë

Datë: 05.07.2024

Ora: 19:30

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi	Vendbanimi
1	Kujtim Maloku	Maloku	Samadrexhë
2	Samir Jurdullu	Jurdullu	Samadrexhë
3	Zulqin Turdullu	Turdullu	Samadrexhë
4	Mehdi Malok	Malok	Samadrexhë
5	ZOHULLI H. MALOK	Malok	SAMADREXHË
6	SAMIR MALOKU	Maloku	SAMADREXHË
7	Ahmet Maloku	Malok	Samadrexhë
8	Ditir Badolli	Badolli	Samadrexhë
9	Alban Malok	Malok	Samadrexhë
10			
11			
12			
13			
14			
15			
16			